



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajjtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

## V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajjtshme komunale me pronën e paluajjtshme në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës.
- II. Prona e paluajjtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës kadastrale nr. 633-0, me sip. 340m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00633-0, Zona kadastrale, Matiçan, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01. nr. 35-642, dt. 01.04.2010, kurse prona e paluajjtshme që merret nga ky këmbim janë parcelat kadastrale nr. 645-9, me sip. 335m<sup>2</sup>, 645-10, me sip. 5m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Matiçan, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00645-9, P-71914050-00645-10, Zona kadastrale, Matiçan, në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës, me destinim gjelbërim të planifikuar sipas Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01.nr. 35-642, dt. 01.04.2010.
- III. Këmbimi i pronës së paluajjtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01. nr.35-642, dt. 01.04.2010.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajjtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajjtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajjtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

### Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-0265331/18, dhe 05, nr. 350/02-0297567/18, dt. 12.06.2019, sipas kërkesës nr. 13-464/01-75147/21, dt. 27.04.2021, ka kërkuar që të këmbëhet parcela kadastrale nr. 645-9, sip. 335 m<sup>2</sup>, 645-10 Zona kadastrale, Matiçan, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00645-9 dhe nr. P-71914050-00645-10, Zona kadastrale, Matiçan, në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës, me destinim gjelbërim, të planifikuar sipas Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01.nr.35-642, dt. 01.04.2010.

Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelës së tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01. nr. 35-642, dt. 01.04.2010, parcela me nr. 633-0, Zona kadastrale, Matiçan, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa parcelat nr. 645-9, 645-10, Zona kadastrale, Matiçan shtrihen në infrastrukturë publike, rrugë të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-463/03-112360/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

